

RREGULLAT NË ASAMBLENË E GJYKATËSVE TË EULEX-IT

Neni 1

Asambleja e Gjykatësve të EULEX-it

Asambleja e Gjykatësve të EULEX-it është themeluar si trup vetëqeverisës.

Asambleja është e përbërë nga të gjithë gjykatësit e caktuar për të ushtruar funksionin gjyqësor dhe të monitorojnë, udhëzojnë dhe të këshillojnë në pajtim me modalitetet e përcaktuara nga Misioni i EULEX-it në KOSOVË.

Asambleja është përgjegjëse për menagjimin e të gjitha çështjeve lidhur me administratën dhe punën e gjykatësve të EULEX-it në pajtim me ligjin, të rregullave aktuale dhe EULEX-it në Kosovë.

Në kryerjen e funksioneve gjyqësore gjykatësit e EULEX-it do të jenë të pavarur në pajtim me standardet më të mira Evropiane dhe principet e Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut..

Asambleja dhe Kryetari i saj janë rojtarë të pavarësisë gjyqësore.

Për më tepër, Asambleja është përgjegjëse:

- të vendosë për çdo kërkesë për diskualifikimin e Kryetarit të Asamblesë së gjykatësve të EULEX-it.
- të zgjedhë me votim të fshehtë gjykatësit që përbëjnë panelin për përzgjedhjen e gjykatësve në të ardhmen.
- të zgjedhë me votim të fshehtë anëtarët e Bordit Disciplinor
- të vendosë për çdo ankesë rreth vendimit disiplinor
- të vërtetojë, me kërkesën e Kryetarit të Asamblesë, rregullat e çështjes së përzgjedhjes dhe të alokimit bazuar në kriterin e objektivave të paracaktuara dhe sigurisë procedurale.
- të raportojë mbi funksionet e monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit
- të organizojë trajnime të vazhdueshme të gjykatësve të EULEX-it

Asambleja do të jetë një forum i hapur për shkëmbimin e përvojave, zgjidhjeve dhe praktikave më të mira të punës.

Neni 2

Kryetari

Kryetari i Asamblesë do të thërrasë, përgatit agjendën dhe kryesojë në mbledhjet e Asamblesë dhe do të ushtrojë këto funksione në pajtim me ligjin, rregullat aktuale dhe EULEX-it KOSOVË.

Neni 3

Zëvendës Kryetari

Kryetari mund të emërojë zëvendës kryetarin i cili mund ta zëvendësojë kryetarin në rast të mungesës apo mosaftësisë së tij dhe ai apo ajo do të ushtrojë funksionet e dhëna sipas rregullave aktuale dhe atyre të deleguara nga ana e kryetarit .

Anëtar i më i vjetër i asamblesë i caktuar sipas moshës kryeson me asamblenë në rast të mungesës apo paaftësisë së zëvendës kryetarit nëse kryetari konsideron se mbledhja nuk mund të shtyhet.

Neni 4

Bordi i Kryesisë

Bordi i kryesisë duhet të themelohet për të mbështetur kryetarin në aktivitetet e saj/tij të menagjimit të gjyqit, përzgjedhjes së dosjeve dhe alokimin e dosjeve.

Bordi përbëhet prej shtatë anëtarësh përveç kryetarit: zëvendës kryetari, kryetari (ose kryesuesi) i Sektorit për Krimet e Luftës dhe krimet e lidhura me dhunën të secilës gjykatë qarku, kryetari (ose koordinatori) i Dhomave të Posaçme.

Bordi mund t'i japë kryetarit këshilla në raste urgjente.

[Kryetari ose në mungesën e tij apo të saj, zëvendës kryetari mund të marrë vendime të jashtëzakonshme, nëse shtyrja mund të shkaktojë dëme ose paragjykime. Të gjitha vendimet e tilla të jashtëzakonshme duhet të raportohen në asamblenë e ardhshme.

Shënimet nga mbledhja e Bordit të Kryesisë do të mbahen në Sekretariatit e Asamblesë. Sekretariati do të mbajë shënimet dhe do t'i ruajë në arkivë [për referencë në të ardhmen nga ana e anëtarëve të asamblesë].

Anëtarët e bordit janë pikat kryesore të gjykatave përkatëse në raport me kryesinë.

Neni 5

Sekretariati i Asamblesë

Sekretariati i Asamblesë do të ndihmohet nga asistenti i kryetarit dhe nga zyrtari kontaktues për çështjet e lidhura me drejtësinë. Ata do të përgatisin materialet dhe dokumentet e duhura, nxjerrin shënimet nga mbledhja dhe të sigurojnë ekzekutimin e vendimeve.

Kryetari do të vendosë për funksionet e sekretariatit.

Neni 6

Mbledhja e Asamblesë

Asambleja mbledhet së paku një herë në çdo tre muaj.

Asambleja do të mbahet në secilën gjykatë qarku në baza alternuese.

Anëtarët e asamblesë do të marrin thirrjen dhe agjendën e asamblesë së paku pesë ditë para datës së caktuar për mbledhje.

Secili anëtar ka të drejtë të kërkojë nga kryetari që të miratojë një nen në agjendë.

Në parim, mbledhjet e asamblesë nuk janë publike. Asambleja mund të thërrasë përfundimisht persona të thjeshtë apo juridikë si ekspertë, mbikqyrës, të ftuar apo në cilësi të tjera, e që asambleja i konsideron të përshtatshme.

Neni 7

Shqyrtimet

Asambleja si trup shqyrtues do të ketë të drejtën të vendosë në rast se 2/3 e anëtarëve të saj janë të pranishëm.

Shqyrtimet miratohen me vota të hapura dhe votat më të favorshme të shumicës së të pranishmëve. Në rast të propozimeve të kundërta vota miratohet me hedhje shorti. Propozimi që merr shumicën e votave miratohet.

Në rast se nuk ka mazhorancë absolute, atëherë kryetari do të ketë votën përcaktuese.

Asambleja zgjedh me votim të fshehtë gjykatësit të cilët përbëjnë panelin për përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe Bordin Disciplinor.

Diskutimi i gjërë dhe kërkimi i marrëveshjes së përgjithshme do të ishte në të mirën e të gjithëve.

Neni 8

Rezolutat

Asambleja mund të marrë të gjitha rezolutat të rëndësishme për ushtrimin e funksioneve të saj.

Neni 9

Komisionet dhe komitetet

Asambleja mund të themelojë grupe punuese që kanë për qëllim studimin e çështjeve të ndërlikuara dhe përgatitjen e propozimeve për asamblenë.

Asambleja mund të krijojë komitete për trajtimin e çështjeve specifike.

Neni 10

Publikimi i vendimeve

Vendimet e asamblesë janë publike. Asambleja mund të vendosë që një vendim të mbahet i fshehtë nëse ka arsye sigurie, mbrojtje të fshehtësisë profesionale, mbrojtje të konfidencialitetit të jetës private të gjykatësve ose palëve të treta.